

Në përputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723/2007 Për Qendrën Kombëtarë të Regjistrimit Ky dokument përbën:

**AKT THEMELIMI  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË**

**"COMPATIBILITÀ" SH.P.K**

**("Statuti")**

**i**

**Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**"COMPATIBILITÀ" SH.P.K**

**("Shoqëria")**

**Neni 1**  
**Emri i Shoqërisë dhe forma ligjore**

- a) Në bazë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, themelohet Shoqëria "Compatibilità" SH.P.K e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shtojca "SH.P.K" që përfaqëson formën juridike të saj, së cilës këtej e tutje do i referohemi shkurtimisht si "Shoqëria"
- b) Shoqëria ka statusin e Personit Juridik, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ("Ligji për Shoqëritë") dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- c) Shoqëria fiton personalitet juridik nga moment i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ("QKR"), në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- d) Ortaku i Shoqërisë ("Ortaku" ose "Ortaku i Vetëm") dhe për shmangien e çdo dyshimi Ortaku themelues, gëzon përgjegjësi të kufizuar deri në kufirin e kontributeve përkatëse të tij në kapitalin e përfaqësuar në kuota.
- e) Në çdo dokument, fatura, njoftimet apo publikime të kryera nga Shoqëria, pavarësisht nga mjetet e transmetimit, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose të ndiqet nga:
  - Fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SH.P.K"
  - Numri unik i identifikimit (NIPT)
  - Selinë e regjistruar dhe zyrën qendrore
  - Të dhëna nëse Shoqëria është në proces likuidimi

**Neni 2**  
**Selia**

- a) Selia ligjore e Shoqërisë do të jetë: Rruga Koli Bano, Nd 10, H3, Njësia Bashkiake nr. 11, Tiranë.
- b) Shoqëria me Vendim të Ortakëve mund të zhvendosë selinë e saj ose të krijojë një qendër operative në një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë ose linjë shërbimi përfaqësimi në çdo vend brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë sipas gjykimit të Ortakëve.

**Neni 3**  
**Objekti i Aktivitetit të Shoqërisë**

- a) Objekti i Aktivitetit të Shoqërisë është:
  - Shërbime të mbajtjes së kontabilitetit
  - Shërbime përditësimi dhe organizimi të kontabilitetit
  - Shërbime të përgatitjes së pasqyrave financiare dhe raporteve financiare
  - Shërbime këshillimi në fushën e tatim-taksave
  - Shërbime këshillimi financiar
  - Shërbime këshillimi fiskal
  - Shërbime këshillimi në raport me kuotat, aksionet apo tregtimin e tyre.
  - Shërbime vlerësimi të pasurivë të paluajtshme
  - Trajnime profesionale
  - Shërbime rekrutim personeli

Gjithashtu në përputhje me legjislacionin shqiptar, mund të kryejë dhe realizojë çdo aktivitet, që

lidhet direkt ose indirekt, që është pasojë apo e lidhur me aktivitetet e listuara me lart. Për të arritur qëllimin e mësipërm, Shoqëria mund të ndërmarrë çdo aktivitet dhe shërbim qoftë tregtar, financiar, për dhënie e marrje me qira e hipotekim, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në mënyrë që të arrihet objekti i Shoqërisë.

- b) Shoqëria mund të ndërmarrë çdo veprimtari që është në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj, i lidhur me të dhe në interes të saj.
- c) Shoqëria mund të krijojë ose të marrë pjesë në shoqëri, sipërmarrje të përbashkëta, partneritete dhe të gjitha format e bashkëpunimit, brenda qëllimit dhe objektivave të saj.
- d) Shoqëria duhet të zbatojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo duhet t'i përmbahet standardeve më të mira etike.
- e) Shoqëria ka të drejtën të bëjë ndryshime të qëllimit të aktivitetit të saj në çdo kohë sipas këtij Statuti.

#### **Neni 4**

#### **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë të pakufizuar duke filluar nga koha e regjistrimit në QKR. Për shkaqe dhe arsye të ndryshme, Shoqëria mund të mbarojë aktivitetin e saj në çdo kohë. Kjo do të bëhet në përputhje me normat e statutit dhe legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 5**

#### **Kapitali i Regjistruar dhe Kontributet në Kapital**

- a) Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë është 10.000 LEKË (dhjetë mijë lekë). Kuota është e pjestueshme, e transferueshme, e trashëgueshme në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- b) Kapitali Themeltar i Shoqërisë prej 10.000 LEKË (dhjetë mijë lekë) zotërohet si më poshtë:
  - o Zj. Lili Dulo, lindur në Tiranë më datë 05/05/1989, identifikuar me Numër Personal 1955050875. Kontributi i saj në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë do të jetë në shumën 10.000 LEKË (dhjetë mijë lekë), e cila e bën Zj. Lili Dulo zotëruese të 100% (njëqind përqind) të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.
- c) Depozitimi i Kapitalit Themeltar të Ortakut në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë do të kryhet me një kontribut të vetëm në para dhe do të paguhet dhe depozitohet përmes një llogarie bankare të hapur në një institucion bankar operues në Republikën e Shqipërisë.
- d) Shoqëria mund të vendosë për mbajtjen e librit të ortakëve, nën kujdesin e Administratorit, me qëllim për të reflektuar çdo të drejtë të Ortakëve apo të palëve të treta mbi kuotat e Shoqërisë (Libri i Ortakëve). Libri i Ortakëve do të përmbajë këto informacione:
  - o Numrin e kuotave të zotëruara nga Ortaku/ët;
  - o Datën kur Ortaku apo Ortakët kanë fituar pronësinë mbi kuotat
  - o Emrin dhe adresën apo selinë e Ortakut (Ortakëve)
  - o Vlerën e kuotave përkatëse të zotëruara; dhe
  - o Të dhëna mbi çdo peng apo çdo të drejtë tjetër reale mbi kuotat.
  - o Ortaku (Ortakët) kanë të drejtën që me anë të kërkesës me shkrim, të kërkojnë një ekstrakt të Librit të Ortakut me vulën e Shoqërisë. Ortaku (Ortakët) ka të drejtën të verifikojë regjistrimin në Librin e Ortakut (Ortakëve) dhe Administratorin (Administratorët) duhet të sigurojnë asistencën e nevojshme për Ortakun (Ortakët).
- e) Kuotat do të transferohen në përputhje me Ligjin për Shoqërite Tregtare dhe do të regjistrohen



në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si dhe në Librin e Ortakut (Ortakëve)

#### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit**

- a) Në vijim, Ortaku mund të vendosë të zmadhojë ose të zvogëlojë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë në çdo kohë në përputhje me nenet e këtij Statuti dhe në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- b) Shoqëria ka të drejtë të blejë dhe të anulohet kuotat e saj, si rezultat i zvogëlimit të kapitalit të regjistruar.
- c) Kapitali i Regjistruar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve në para ose kontributeve në natyrë, si edhe përmes përfshirjes në to të rezervave ose fitimeve apo edhe përmes konvertimit të borxheve në kuota kapitali.
- d) Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet përmes sigurimit të kuotave të reja ose rritjes të vlerës nominale të kuotave ekzistuese. Kuotat duhet të regjistrohen dhe vlera e tyre nominale duhet të paguhet plotësisht.

#### **Neni 7**

#### **Drejtimi dhe Organizimi i Shoqërisë**

Drejtimi i Shoqërisë është i ndarë ndërmjet:

- a. Ortakut (Ortakët)
- b. Administratori/ët.

#### **Neni 8**

#### **Ortaku**

- a) Ortaku/ët është organi më i lartë i vendimmarrjes në Shoqëri.
- b) Pronësia mbi kuotat i jep zotëruesit të tyre të drejtat dhe detyrimet, siç parashikohen në Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga pronësia mbi kuotat janë të transferueshme në çdo zotërues të ri të këtyre Kuotave.
- c) Ortaku/ët ka të drejtën për të vendosur mbi:
  - Përcaktimin e politikave tregtare dhe të investimit të shoqërisë.
  - Ndryshimin e statutit.
  - Emërimin dhe shkarkimin e administratorit (administratorëve) dhe miratimin e skemave të shpërblimeve të tyre.
  - Emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar të pavarur dhe likujduesve dhe miratimin e skemës së shpërblimeve të tyre.
  - Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore, llogarive dhe raporteve të ecursisë së veprimtarisë nga administratorët.
  - Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecursisë së veprimtarisë, mbi bazën e dokumentave përkatës.
  - Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë, mbi bazën e dokumentave përkatëse.
  - Shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve.
  - Pjestimi i kuotave dhe anulimin e tyre.
  - Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit

(administratorëve).

1. Hapjen e degëve dhe filialeve.
  2. Zbatimin e nenit 17 të ligjit të shoqërisë tregtare mbi ndalimin e konkurrencës. Çdo çështje tjetër siç parashikohet në nenin 82 të ligjit për shoqëritë tregtare.
  3. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë; dhe
  4. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji për shoqëritë tregtare.
- d) Ortaku/ët mund të thirret për të vendosur për çështjet e mëposhtme, si një kërkesë e detyrueshme e nenit 82 të Ligjit për Shoqërite Tregtare.
- o Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton risku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - o Kur ka një propozim për të shitur apo për të disponuar në mënyre tjetër aktive asete të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- e) Në përputhje me nenin 92 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Ortaku/ët mund t'i kërkojë gjykatës përkatëse anulimin e vendimeve të Administratorit (Administratorëve), kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të Statutit apo të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- f) Detyrimet e Shoqërisë, janë të garantuara përmes kapitalit e saj, dhe Ortaku (Ortakët) kanë përgjegjësi deri në vlerën e kuotave të mbajtura prej tij/tyre. Ortakët nuk kanë përgjegjësi përtej vlerës së investimeve të tyre në kapitalin e Shoqërisë (me përjashtim të huave dhe garancive).
- g) Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhet apo detyrimet të tjera personale të Ortakut (Ortakëve) të saj.

## Neni 9

### Proçesi i Vendimarrjes së Ortakut

- a) Ortaku/ët mund të marrë vendim përmes thirrjes në mbledhje apo në formë të shkruar, në çdo rast kur konsiderohet në të mirë të Shoqërisë.
- b) Në rast se Ortaku/ët do të marrë vendim në formën e shkruar, Administratori (Administratorët) do t'i dërgojë Ortakut tekstin e vendimit të propozuar së bashku me dokumentacionin që mbështet vendimin me postë, faks apo me mjete elektronike të sigurta të paktën 7 (shtatë) ditë para datës së propozuar për mbledhjen e asamblesë. Ortaku duhet të miratojë dhe të kthejë vendimin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dërgimit tek Ortaku/ët të vendimit me shkrim. Ortaku miraton vendimin duke kthyer një kopje të firmosur të vendimit të shkruar tek Administratori (Administratorët) në selinë e Shoqërisë.
- c) Vendimet e Ortakut të hartuara në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe Statutin do të kenë fuqi detyruese për Shoqërinë. Vendime të tilla mund të merren jashtë Republikës së Shqipërisë dhe evidenca me shkrim e këtij vendimi duhet t'i dorëzohet Administratorit (Administratorëve), i cili (të cilët) duhet ta regjistrojë në Regjistrin e Vendimeve të Ortakut (Ortakëve).
- d) Ortaku thirret për vendimarrje nga Shoqëria të paktën një herë në vit dhe kjo thirrje është e detyrueshme.
- e) Administratori (Administratorët) duhet të sigurojë që njoftimi i Ortakut të jetë në përputhje me formën dhe përmbajtjen e nenit 83 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Mospërmbushja e formaliteteve të njoftimit i bën vendimet e Ortakut të pavlefshme, vetëm nëse Ortaku njih dhe pranon parregullsitë, deri në masën e lejuar nga ligji.



- f) Në rastet ku kërkohet nga ligji, disa vendime të Ortakut duhet të noterizohen nga një noter publik shqiptar. Nëse këto vendime janë marrë jashtë Republikës së Shqipërisë, ato duhet të hartohen në përputhje me ligjin Shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Republikën e Shqipërisë (p.sh procedurat e apostilimit apo superlegalizimit, sipas vendit të marrjes së vendimit).
- g) Të gjitha vendimet e Ortakut të vetëm duhet të regjistrohen në procesverbal dhe në regjistrin e vendimeve të Ortakut. Mbajtur nën kujdesin e Administratorit (Administratorëve) dhe në përputhje me nenin 90 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare ("Regjistri i Vendimeve të Ortakut"). Të dhënat e hedhura në këtë regjister nuk mund të tjetërsohen apo të ndryshohen.

### **Neni 10 Administratori**

- a) Shoqëria administrohet nga një administrator
- b) Ortaku/ët mund të ndryshojë në çdo kohë nëse e konsideron të nevojshme numrin e administratorëve.
- c) Administratori mund të jetë i çdo shtetësie dhe emërohen për një periudhë pesë vjeçare me të drejtë riemërimi.
- d) Sipas nenit 95 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe nenit 13 të po këtij ligji, i cili citon kushtet e kualifikimit, administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të emërohet, si administrator të një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.
- e) Në rastet e vdekjes, dorëheqjes, largimit, apo diskualifikimit të çdo Administratori/ët, zëvendësuesi i tij duhet të emërohet me vendim të Ortakut/(Ortakëve).
- f) Ortaku (Ortakët) ka të drejtë të largojë Administratorin (Administratorët) me vendim me shkrim.
- g) Administratori pranon se marrëdhënia e tij në Shoqëri bazohet në mirëbesim, në këtë mënyrë vendimi i Ortakut (Ortakëve) për të larguar administratorët konsiderohet një arsye legjitime, në bazë të legjislacionit të zbatueshëm.
- h) Në rastet kur për lidhjen, ndryshimin dhe zgjidhjen e transaksionit (transaksioneve) kontratës (kontratave) kërkohet një marrëveshje e përbashkët e administratorit (Administratorëve) dhe një marrëveshje e tillë nuk arrihet çështja do t'i referohet Ortakut (Ortakëve) i cili do të zgjidhë çështjen me vendim.
- i) Ortaku mund të miratojë vendimin i cili i jep të drejtën Administratorit (Administratorëve) që të përfaqësojnë të gjithë bashkë ose individualisht dhe/ose të drejtën për të kryer disa transaksione.
- j) Administratori duhet të kryejë në çdo kohë ato veprime të kërkuara nga Ortakët në përputhje me këtë Statut dhe ligjin.
- k) Administratori i parë dhe i vetëm i Shoqërisë do të jetë:
  - o Lili Dulo, lindur në Tiranë më datë 05/05/1989, identifikuar me Numër Personal Identifikimi 1955050875
- l) Administratori mund të hapë llogari bankare me firmë të vetme.
  - o Lili Dulo është e autorizuar të kryejë të gjitha transaksionet e nevojshme për të hapur llogarinë përkatëse me qëllimin e depozitimit të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- m) Shoqëria duhet të rimbursojë Administratorin për shpenzimet e udhëtimeve të arsyeshme të lidhura me prezencën e Administratorit në një vend jashtë vendbanimit të Administratorit në të mirë të Shoqërisë, vetëm nëse ky rimbursim është bërë pjesë e shpërblimit të të njëjtës.



**Neni 11**  
**Të drejtat e Administratorit**

- a) Administratori është përgjegjës për drejtimin dhe përfaqësimin e Shoqërisë.
- b) Në veçanti Administratori ka të drejtën dhe detyrimin për të vendosur personalisht dhe të përfaqësojë shoqërinë në:
1. Drejtimin e biznesit të Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare të krijuara nga Ortakët.
  2. Të kujdeset për mirëmbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave të kontabilitetit të Shoqërisë.
  3. Përgatisë dhe nënshkruajë pasqyrat fiianciare vjetore dhe të konsoliduara, si dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë duke i paraqitur për miratim te Ortaku bashkë me propozimin për shpërndarjen e fitimeve.
  4. Krijimin e një sistemi paralajmërimi në kohën e duhur në lidhje me rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë.
  5. Raportimin tek Ortaku në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve të një rëndësie të veçantë për veprimet e Shoqërisë;
  6. Supozimin, sipas formës së një marrëveshjeje ose çdo formë tjetër, e çdo sipërmarrjeje të Shoqërisë kundrejt të tretëve si dhe transferimin apo blerjen e çdo kuote të Shoqërisë nga apo për palët e treta.
  7. Supozimin, sipas formës së një marrëveshjeje ose çdo forme tjetër, lidhjen e çdo kontrate apo ndërmarrjen e çdo veprimi apo transaksioni.
  8. Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara nga ligji apo Ortaku/ët.
  9. Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit kur është e nevojshme.

**Neni 12**  
**Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia e Administratorit**

- a) Sipas detyrimit të besnikërisë të paraqitur në Nenet 14,15,17 dhe 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori (Administratorët) duhet të:
- kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara nga ligji apo ky Statut në mirëbesim dhe në interes të Shoqërisë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;
  - ushtrojnë kompetencat që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - vlerësojnë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
  - parandalojë dhe mënjanon rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë;
  - garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
  - ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
- b) Administratori (Administratorët) gjatë kryerjes së detyrave përgjigjen kundrejt Shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e Shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- c) Në rast të shkeljes së detyrës dhe standarteve profesionale, sipas pikave 18.1 dhe 18.2 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë, për dëmet



që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë Shoqërisë çdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të parregullta. Ai ka barrën e provës për të vërtetuar se kryen detyrat e tij në rregull dhe sipas standarteve. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administrator ata përgjigjen ndaj Shoqërisë në mënyre solidare.

- d) Në veçanti, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë për dëmet nëqoftëse në kundërshtim me ligjin kryen veprimet e mëposhtme
- a. I kthen Ortakut/ve kontributet
  - b. I paguan interesa apo dividendë ortakëve
  - c. Kryen shpërndarjen e Aseteve të Shoqërisë
  - d. Lejon të vazhdojë aktivitetin e Shoqërisë kur duhet parashikuar që ajo nuk do të ketë mundësi të paguajë borxhet e saj.
  - e. Të japë hua/borxhe në kushte vështirësie financiare

## **VEPRIMTARIA E SHOQËRISË**

### **Neni 13**

#### **Ekspertët Kontabël**

- a) Ortaku emëron ekspertin kontabël të shoqërisë në numrin dhe kohëzgjatjen e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar
- b) Eksperti kontabël do të kryejë funksionet e auditimit në përputhje me ligjin shqiptar
- c) Mandati i Ekspertëve Kontabël do të jetë një vjeçar
- d) Viti Financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Viti i parë financiar fillon me datën e themelimit të Shoqërisë.
- e) Shoqëria do të mbajë llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj.

### **Neni 14**

#### **Kuotat e Shoqërisë**

- a) Kuotat e Shoqërisë janë lehtësisht të transferueshme në përputhje me ligjin për Shoqëritë Tregtare dhe në veçanti me nenin 73 të këtij Ligji.
- b) Ortakët mund ti ndajnë kuotat e tyre me qëllimin e transferimit të pjesëve të këtyre kuotave në përputhje me ligjin Shqiptar për Shoqëritë Tregtare.

### **Neni 15**

#### **Shpërndarja e fitimeve**

- a) Ortaku ose ortakët ka të drejtën e përfitimit prej shpërndarjes së fitimit të deklaruar të Shoqërisë bazuar në bilancin e Shoqërisë të miratuar nga Ortaku ose Ortakët
- b) Nga fitimet vjetore krijohet një fond rezervë në përputhje me kushtet e legjislacionit Shqiptar
- c) Shoqëria mund të shpërndajë fitimet tek ortakët vetëm nëse pas kësaj shpërndarjeje:
  - o Asetet e Shoqërisë do të mbulojnë plotësisht detyrimet e saj
  - o Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që do të bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm
- d) Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila shpreh se shpërndarja e propozuar e dividendeve përmbush kërkesat e pikës 15.c. Në të kundërt, nëse gjendja e





Shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund të lëshojnë këtë certifikatë.

- e) Administratorët janë përgjegjës ndaj shoqërisë në lidhje me vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese
- f) Sipas nenit 78 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare ortaku/ët dhe administratori/rët e shoqërisë kanë përgjegjësi personale për shpërndarjet të cilat bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

### **Neni 16** **Dispozita të ndryshme**

- a) Ky statut mund të ndryshohet ose të zëvendësohet me një tjetër vetëm me vendim të ortakut/ëve.
- b) Riorganizimi, ndryshimi i formës ligjore apo prishja e Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- c) Ortaku/ët dhe administratori/ët do të veprojnë me parimet e ligjit për shoqëritë Tregtare dhe në veçanti në përputhje me dispozitat e pjesës së parë, kapitulli 4 të ligjit Për Shoqëritë Tregtare.
- d) Personat të cilët janë përfshirë në krime të kryera gjatë detyrës së tyre në Shoqëri sipas nenit 163 deri 170 pika a) e Kodit Penal nuk mund të kryejnë funksionet e përfaqësuesit ligjor, administratorit dhe të përfaqësuesit të shoqërisë për një periudhë prej 5 vjetësh nga kryerja e dënimit.
- e) Shoqëria duhet të përfshijë në raportin e saj vjetor një pasqyrë koherente dhe përshkruese, e cila përmban pikat kyçe të rregullave për drejtimin e Shoqërisë dhe praktikave që aplikon në përputhje me ligjin për Shoqëritë tregtare.
- f) Ortaku me propozimin e Administratorit/ve, mund të vendosë për krijimin e një fondi rezervë për të përmbushur risqet e papriturat të Shoqërisë, për barazimin e fitimeve, për ruajtjen e çdo pasurie të Shoqërisë, ose për çdo qëllim tjetër që ortaku konsideron në interes të Shoqërisë.
- g) Të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar shprehimisht në këtë Statut, i nënshtrohen rregullimit nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

**ORTAKU**

**Lili Dulo**

**Tiranë, më 13.11.2023**

*Lili Dulo*  
